



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Nr. 13

Datë: 06. 05. 2019. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Adnan Rustemi, Florian Dushi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Čemailj Kurtišti.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
 - 2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Këshillave të Vendvotimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveqan dhe Zubin Potok:
 - 3. Të ndryshme.**
-

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Rendi i ditës është para jush...Kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i Këshillave të Vendvotimit për zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveqan dhe Zubin Potok:

Adnan Rrustemi: KOZ, i ka shqyrtuar nominimet për këshillat e vendvotimeve, por ne kemi dhënë disa vërejtje dhe disa sugjerime për Sekretariatit që, me vendosë edhe njëherë komunikimin me KKZ-në që të sigurohemi se gjithçka është marrë për bazë, përndryshe, ndoshta nuk është përbërja më adekuate por...!

Enis Halimi: Është e vërtetë që ne kemi marrë sugjerimet, dhe do ti diskutojmë edhe njëherë...Kemi vendosur kontaktet me KKZ-në atje, situata është e tillë atje, dhe zgjidhja më e mirë janë këto propozime që kanë ardhur...

Stevan Veslinoviq: Lidhur me Mitrovicën e veriut, këtu janë 27 vendvotime, kurse kryesues janë 12...Por po shoh që janë më shumë, ka ndonjë gabim apo...?

Adnan Rrustemi: 27 kryesues duhet të jenë...

Valdete Daka: Me gjasë, është gabim teknik...Të rishikohen, dhe të përmirësohet...

Me këto ndryshime, përmirësime sipas vërejtjeve që u dhanë, kush është për rekomandimin e KOZ-it...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimet e KOZ-së lidhur me nominim e Këshillave të Vendvotimeve për zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveqan dhe Zubin Potok.

